

VENDIM
Nr. 520, datë 1.8.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 641, DATË 1.10.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR EKSPORTIN E MBETJEVE DHE KALIMIN TRANSIT TË MBETJEVE JO TË RREZIKSHME E TË MBETJEVE INERTE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 50 e 51, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 641, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në vendim, fjalët “... përgatit dhe dorëzon ...” zëvendësohen me “ ... dërgon elektronikisht nëpërmjet portalit unik qeveritar “*e-Albania*” ...”.

2. Shkronja “a”, e pikës 4, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) vendimit nr. 402, datë 30.6.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve”;

3. Pas pikës 10 shtohet pika 10/1, me këtë përmbajtje:

“10/1. Ministria ngarkon në portalin unik qeveritar “*e-Albania*” konfirmimin/pëlqimin me shkrim, të përcjellë nga autoriteti kompetent, të destinacionit dhe/ose të transitit.”.

4. Pika 24 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“24. Të dhënat e ruajtura sipas pikës 23, të këtij vendimi, pas nënshkrimit elektronik nga personi fizik/juridik raportohen në ministri dhe në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit çdo 6 (gjashtë) muaj gjatë afatit të autorizimit, nëpërmjet sistemit elektronik.

Raportimi i të dhënave të ruajtura sipas afatit të autorizimit përbën kusht për shqyrtimin e aplikimit pasardhës. Ministria krijon Regjistrin Kombëtar të Eksportit të Mbetjeve për eksportin dhe transitin e mbetjeve. Format i regjistrit dhe mënyra e administrimit të tij miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

5. Në pikën 26, fjalët “... 30 ditë kalendarike.” zëvendësohen me “... 20 (njëzet) ditë pune.”.

6. Pas pikës 35 shtohet pika 35/1, me këtë përmbajtje:

“35/1. Procedura e aplikimit sipas këtij vendimi, nëpërmjet portalit unik qeveritar “*e-Albania*”, zbatohet në momentin që sistemi i integruar mjedisor do të implementohet dhe do të jetë funksional. Deri në funksionimin e tij, dorëzimi i aplikimit dhe tërheqja e autorizimeve për eksportin, transitin e mbetjeve, si dhe raportimi sipas pikës 24, të këtij vendimi, bëhet në ministrinë përgjegjëse për mjedisin.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama